



IOM International Organization for Migration  
IOM Internationale Organisation für Migration

Stand: Januar 2015/Albanisch-Albanien

## REAG-/GARP-Program 2015

**Reintegration and Emigration Program for Asylum-Seekers in Germany (REAG)**

**Government Assisted Repatriation Program (GARP)**

### **Projekti "Ndihma financiare për të kthyerit vullnetarë nga territori i Republikës Federale të Gjermanisë"**

#### **Fletëinformimi**

##### **A. Informata të përgjithshme**

Shpenzimet për udhëtim dhe ndihmë plotësuese janë program i ndihmës humanitare.

Ky program i ndihmon të kthyerit/emigrantët që kthehen me vetëdëshirë në vendlindje, ofron ndihmë financiare dhe shërben për drejtimin e lëvizjeve të migracionit.

IOM e zbaton këtë projekt me urdhër të Ministrisë Federale të Punëve të Brendshme dhe Ministrive përgjegjëse të krahinave në bashkëpunim me administratën lokale dhe regionale, organizatat humanitare si dhe me Komisaratin e Lartë për Refugjatë të Kombeve të Bashkuara (UNHCR).

Ky program shërben për përgatitjen e organizuar dhe implementimin e kthimit të të kthyerve dhe migrantëve. Kushti për të përfitur nga projekti është që as azil kërkuesi/i kthyeri i cili paraqet kërkesën për kthim, e as ndonjë person apo ent tjetër përgjegjës për mbështetje, nuk mund të përballojë shpenzimet e udhëtimit. Për të përfitur shpenzimet e përgatitjes së kthimit (psh. Taksat për pasaporta dhe viza, udhëtimi deri në aeroport apo në konsullatë për intervistë), duhet paraqitur kërkesën në entin përkatës për punë sociale apo ndonjë sponsor tjetër përgjegjës. Për emigrim në vende të treta, paraprakisht duhet poseduar vizat e vlefshme për qëndrim në atë shtet.

##### **B. Llojet e ndihmave:**

**Në kuadër të këtij programi mund të përfitohen këto ndihma:**

- Shpenzimet për udhëtim ( me aeroplan, tren ose autobus)
- Shpenzimet për karburant nëse udhëtoni me makinë: në shumë prej 250 "
- Ndihmë shtesë për shpenzime udhëtimi në shumë prej 200 " për të rritur, gjegjësisht 100 " për fëmijë deri në moshën 12 vjeçare.

Shtetasve të Serbisë, Bosnje dhe Hercegovinës, IRJ Maqedonisë, dhe Malit të Zi, të cilët kanë ardhur në Republikën Federale të Gjermanisë pas lirimit nga detyrimi i posedimit të vizës hyrëse, nuk mund t'ju pranohet kjo Ndihmë shtesë për shpenzime udhëtimi dhe ndihmë shtesë:

- Serbisë, IRJ Maqedonisë dhe Malit të Zi . nga 19.12.2009
- Bosnje dhe Hercegovinës dhe Shqipërisë . nga 15.12.2010

**IOM Ë Vertretung für Deutschland:**

Michaelkirchstr. 13 ~ D-10179 Berlin ~ Deutschland ~ Fax: +49.30.278 778 99

**IOM - Zweigstelle in Nürnberg:**

Postfach 44 01 59 ~ D-90206 Nürnberg ~ Frankenstraße 210 ~ D-90461 Nürnberg ~ Deutschland ~ Fax: +49.911.4300 260

**Telefonzentrale IOM Deutschland: +49.911.43000**

E-Mail: [IOM-Germany@iom.int](mailto:IOM-Germany@iom.int) Internet: <http://germany.iom.int>

### C. Parashtrimi i kërkesës

**Kërkesat për të marrë shpenzimet e udhëtimit në kuadër të këtij programi, mund të paraqiten vetëm përmes administratës lokale apo krahinore (p.sh. entet për ndihmë sociale, zyra për të huaj), organizatave humanitare gjermane, këshillimoreve profesionale, këshillimoreve qendrore për të kthyer ose përmes UNHCR.**

### D. Personat që mund të paraqesin kërkesë dhe parakushtet

Ndihmat financiare në kuadër të këtij programi, mund t'u aprovohen këtyre personave:

- Atyre që marrin ndihmë në bazë të § 1 të ligjit për ndihmë azilkërkuesve
- Atyre që iu është i njohur statusi i refugjatëve të luftës
- Shtetasit e tjerë të huaj të cilëve u është dhënë lejeqëndrimi në baza ndërkombëtare, humanitare apo politike
- Viktimat e prostitucionit të detyruar apo të trafikimit me njerëz

Shtetasve të shteteve anëtare të Bashkësisë Evropiane (BE) nuk iu aprovohet ndihma në kuadër të këtij programi. Përfshirë nga ky rregull bëjnë viktimat e prostitucionit të detyruar apo të trafikimit me njerëz.

Të gjithë shtetasve të tjerë, të cilët kanë ardhur në republikën Federale Gjermane pas lirim të detyrimit për posedimin e vizës hyrëse, nuk mund t'u aprovohen ndihmat shtesë. Përfshirë nga ky rregull bëjnë viktimat e prostitucionit të detyruar apo të trafikimit me njerëz.

**Tek e ashtuquajtura procedura Dublin (Dublin-Verfahren) Ë kthimi në ndonjë shtet tjetër të BE) nuk ekziston mundësia për ndihmën REAG/GARP.**

Të gjithë të kthyerit/emigrantët, në momentin e kthimit, duhet të kenë së paku një sGrenzübertrittsbescheinigung%(vërtetim për kalim të kufirit) dhe dokumente të vlefshme të udhëtimit. Për të kthyerit në Kosovë, nga enti për të huaj, mund të lëshohet EU-Laissez-Passer.

Paraqitësi i kërkesës, me nënshkrimin e vet në kërkesë, duhet të vërtetojë se me vetëdëshirë e lëshon Gjermaninë, të heq dorë nga ankesat dhe mjetet ligjore të hapura tek institucionet e ndryshme dhe ato ligjore dhe poashtu edhe në të drejtën eventuale të lejes së qëndrimit. Nuk guxon të ketë parakushte për hyrje të sërishme për kohë më të gjatë në RF Gjermane. E drejta ligjore për ndihmë financiare në kuadër të këtij projekti, nuk është e pamundur.

### E. Viza për migrantë

Të huajt, të cilët dëshirojnë të emigrojnë në një vend të tretë, së pari duhet t'u drejtohen këshillimoreve për emigrantë, në mënyrë që të marrin të gjitha informatat e nevojshme për mundësitë dhe kushtet e emigrimit (p.sh. Raphaels-Werk, Diakonisches Werk, DRK-Kryqi i Kuq gjerman). Regjistrin e këtyre këshillimoreve mund t'u porosisni tek enti për administratën qendrore (Bundesverwaltungsamt . BVA, Referat II B 6, 50728 Köln, [www.bundesverwaltungsamt.de](http://www.bundesverwaltungsamt.de)). Kërkesat për të marrë shpenzimet për të shkuar në vende të treta në kuadër të këtij programi, mund të paraqiten vetëm pas marrjes së vizës për shtetin përkatës.

### F. Informata të tjera

Informata të tjera për këtë program mund të merrni në qendrat për punë sociale dhe zyrat për të huaj në qytete dhe rrethe rajonale, në entet e shoqatave humanitare, këshillimoret profesionale, këshillimoret qendrore si dhe në IOM në Nürnberg (në gjuhën gjermane ose angleze).

### G. Programi special për migrantët të cilët marrin përsipër vetë shpenzimet e udhëtimit apo migrimit (SMAP)

Personat, të cilëve u nevojitet ndihma financiare por nuk mund të përfitojnë nga ky program, IOM-i përmes programit SMAP (Special Migrants Assistance Program) mund të ua organizojë fluturimin me çmime të përshtatshme. Kjo vlenë sidomos për emigrantët që udhëtojnë në SHBA/Kanada/Australi. Bileta duhet të paguhet para udhëtimit nga udhëtari përkatës ose duhet të ketë garancë nga ana e një sponzori të caktuar që merr përsipër shpenzimet (p.sh. enti për ndihmë sociale, shoqatat humanitare, etj.).